



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1380 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 200, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit arkeologjik në korridorin e ndërtimit të **GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)** në zonën e fshatit Qafë, KM 97+ 250- subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gërmimit arkeologjik në korridorin e ndërtimit të **GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)** në zonën e fshatit Qafë, KM 97+ 250-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të ruhen *In situ* strukturat e zbuluara gjatë gërmimit arkeologjik në korridorin e ndërtimit të **GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)**, në zonën e fshatit Qafë, KM 97+ 250 dhe të merren masa për mbulimin e tyre.
3. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazjellësit TAP, duke u kryer ndjekja në mënyrë periodike ditore e punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 40, datë 24.03.2017, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e III (KM 69-139.674).
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al